KËRKESË PËR APLIKIME # PAQ-PG-01

Grante partneriteti

Projekti i USAID-it për pjesëmarrje qytetare i fton **rrjeti i organizatave të shoqërisë qytetare (OSHQ)** në Maqedoni të aplikojnë për Grantet e partneritetit. Rrjeti i OSHQ-ve i përfshijnë koalicionet, platformat, rrjetet, si dhe rrjeti i OSHQ-ve të regjistruara zyrtarisht dhe të paregjistruara, që kanë më shumë se pesë anëtarë.

Projekti për pjesëmarrje qytetare është program pesëvjeçar i financuar nga USAID-i që kontribuon për arritjen e dy qëllimeve: (1) ndikimin më të madh të OSHQ-ve mbi politikat dhe programet që kanë të bëjnë me çështjet prioritare që i brengosin qytetarët, dhe (2) angazhimin më të madh dhe të qëndrueshëm të të rinjve në jetën publike në Maqedoni. Grantet e partneritetit do të menaxhohen nga Fondacioni Metamorfozis.

Qëllimi i Granteve të parnteritetit është t'i mbështesë rrjetet e OSHQ-ve që: (i) të bëhen udhëheqëse në formësimin dhe në angazhimin konstruktiv për çështjet që e brengosin publikun; (ii) ta përmirësojnë kapacitetin e tyre për t'i përfshirë qytetarët, mediet, institucionet qeveritare dhe palët e tjera të interesuara në përmirësimin e mirëqenies së pulikut, dhe (iii) ta përforcojnë kapacitetin e tyre institucional.

Projekti për pjesëmarrje qytetare do të ndajë më së shumti (2) grante në kuadër të kësaj kërkese për aplikime. Granti maksimal që mund të ndahet për çdo propozim është 120,000 dollarë amerikanë, dhe do të jetë për aktivitete që do të zgjasin më së shumti 3 (tre) vite. Projekti e mban të drejtën që ta financojë cilindo qoftë apo asnjërin nga propozimet e dorëzuara.

Aktivitetet e grantit mund të përfshijnë:

- Përfaqësim (avokatësi), monitoring, analizë të politikave publike, dhe iniciativa për edukim të publikut në këto fusha: qeverisja e mirë, përmirësimi i shërbimeve publike, sundimi i të drejtës, antikorrupsioni, të drejtat e njeriut, rritja ekonomike, mjedisi i përshtatshëm për biznes dhe monitoringu dhe mbikëqyrja e institucioneve publike, dhe
- Aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve të rrjeteve të OSHQ-ve, të cilat mund të përfshijnë krijimin dhe ofrimin e shëbimeve të anëtarësisë për anëtarët e rrjeteve të OSHQ-ve, zgjerimin e rrjeteve të OSHQ-ve me palë të ndryshme të interesuara duke i përfshirë OJQ-të që veprojnë në rajon,

OSHQ-të që i përfaqësojnë grupet e përjashtuara shoqërore, ose/dhe sektorin privat, mediet si dhe sektorin akademik/arsimor; punën e vazhdueshme, këmbëngulëse dhe kreative për t'i përfshirë qytetarët dhe përkrahësit e ndryshëm, si p.sh., mediet, sektorin privat dhe qeverinë në të gjitha aspektet e punës së rrjeteve të OSHQ-ve; dhe përforcimin e rrjetëzimit të rrjeteve të OSHQ-ve me palë të rëndësishme të interesuara në Evropën Juglindore dhe më gjerë.

Për ta shkarkuar Kërkesën e plotë për aplikime, Formularin për aplikim dhe Mostrën e buxhetit për Grantet për partneritete, ju lutemi vizitojeni ueb-faqen www.metamorphosis.org.mk ose shkruajini Gordana Mirchikj-it në e-mail-in: gmirchikj@ewmi.org.

Shkarkoni:

1. Kërkesa e plotë për aplikim (.pdf)
2. Formulari për aplikim(.docx)
3. Mostra e buxhetit për grante për partneritet(.xlsx)

AFATI I FUNDIT PËR DORËZIMIN E PROPOZIMEVE ËSHTË DERI MË 23 DHJETOR 2016, NË ORËN 16:30

Projekti për pjesëmarrje qytetare zbatohet nga East West Management Institute (East-West Management Institute - EWMI), në partneritet me katër organizata nga shoqëria civile (OSHC): Fondacioni për Internet dhe Shoqëri "Metamorfozis", Asociacioni për Iniciativa Demokratike (AID), Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Maqedoni (FSHHM) dhe Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë (KRNM).